



Misioni dhe Vizioni

1. UK-ja në gjithë veprimtarinë e tij ka për mision kryesor të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimit, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Këtë mision ai e realizon përmes këtyre synimeve:

- të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimit dhe praktikave profesionale, duke përmbushur të gjitha detyrat që rrjedhin nga nënshkrimi i Deklaratës së Bolonjës.

- të formojë shkencëtarë të rinj në fusha të ndryshme parësore, duke marrë parasysh drejtimit kryesor të zhvillimit të rajonit, nëpërmjet kërkimit shkencor dhe veprimtarisë botuese;

- si promotor i formës më të lartë të arsimit, synon edhe përvetësimin e kompetencave specifike dhe saktësinë metodologjike për ta bërë individin jo vetëm specialist kompetent, por dhe një qytetar të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë.

- të kryejë studime shkencore për të zhvilluar programet e studimit të shkencave që lëvtron dhe të ofrojë shërbime për zgjidhjen e problemeve më të rëndësishme që ka rajoni i Korçës dhe më gjerë;

- të kryejë kualifikimin e vazhdueshëm të specialistëve të lartë të fushave të ndryshme, duke u kthyer në një qendër e rëndësishme kualifikimi dhe zhvillimi të teknologjive bashkëkohore.

2. t'u sigurojë punonjësve akademikë pavarësinë e kërkimit dhe lirinë e mësimeve, sipas dispozitave të këtij statuti dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. të lëshojë diploma dhe të japë certifikata e tituj të tjerë në përputhje me nivelin e formimit të kryer.

4. të garantojë shprehjen e lirë të ideve dhe t'i sigurojë personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.